



Profil i projektit

Partneriteti i Arsimit Profesional midis Odës së Zejtarisë në Dortmund, shkollës profesionale "Shën Jozefi Punëtor" në Rrëshen (Shqipëri) dhe Dhomës së Industrisë dhe Tregtisë Tiranë (Shqipëri)

Informacion i shkurtër

Oda e Zejtarisë në Dortmund ka realizuar projekte, vlerësimë dhe misione këshilluese si pjesë e projekteve të zhvillimit ndërkombëtar në emër të BMZ dhe GIZ për më shumë se 20 vjet. Projektet mbikëqyren nga OZ e Dortmundit drejtëpërdrejtë ose nga organizata implementuese Hope Consulting GmbH, një sipërmarrje „vajzë“ 100 përqind e OZ të Dortmundit. Qëllimi është zbatimi i elementeve dual të trajnimit, mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në rajonin përkatës të synuar dhe më këtë fushat e mundshme të punësimit, për të luftuar shkaqet e mundshme të ikjes.



Promovuesi i mjetëve	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
Mbajtësi i projektit	Oda e Zejtarisë në Dortmund
Zbatimi i projektit	Hope Consulting GmbH
Partnerë në projekt	Shkolla Profesionale „Shën Jozefi Punëtor“ në Rrëshen dhe Dhomë e Tregtisë & Industrisë Tiranë
Kohëzgjatja e projektit	01.12.2019 – 31.12.2025
Mbështetja teknike	Sequa gGmbH

Çfarë është një Partneritet i Arsimit Profesional?

Qëllimi i projekteve të PAP-s është të mbështes vendet partnere në drejtim të pjesëmarrjes më të madhe nga ekonomia lokale dhe orientimit më të madh praktik në arsimin dhe aftësimin profesional. Projektet e PAP-s përdorin njohuritë e formimit profesional të dhomave dhe shoqatave gjermane dhe institucioneve të tyre të formimit profesional. Këta janë të përfshirë në projektet e PAP-s që kanë realizuuar dhe mbështesin organizatat partnere të zgjedhura, p.sh. shkollat profesionale, dhomat, shoqatat, për trajnim profesional të bazuar në nevoja. Prioritetet tipike të bashkëpunimit janë:

- Këshilla organizative dhe menaxhuese.
- Këshillë për krijimin dhe zgjerimin e formave bashkëpunuese të trajnimit.
- Promovimi i dialogut midis institucioneve shtetërore arsimore dhe sipërmarrjeve.
- Trajinim i mëtutjeshëm i mësuesve të shkollave profesionale dhe trajnerëve të ndërmarrjeve.
- Futja e kurseve të trajnimit të modelit të orientuar nga praktika.
- Mbështetje për analizën e nevojave, kurrikulën, materialet mësimore dhe të provimeve etj.



Cilat janë qëllimet konkrete të PAP-s në Shqipëri?

Qëlliimi i strategjik i PAP-s është të përmirësojë mundësitë e përgjithshme të punësimit të grupeve të synuara të projektit në Shqipërinë Veriore duke përmirësuar mundësitë e punësimit të absolventëve të shkollës dhe pjesëmarrësve në masa të mëtutjeshme trajnimi dhe duke kontribuar në rimëkëmbjen ekonomike të Shqipërisë së Veriut. Këto synime të projektit konkretizohen si mëposhtë:

- Pjesëmarrësit në masat e kualifikimit aftësohen në përputhje me tregun dhe gjejnë punësim profesional adekuat dhe të ardhura të përshtatshme.
- Sipërmarrjet lokale (përfshirë NVM-e) gjjejnë punonjës të kualifikuar dhe mund të përmirësojnë dhe zgjerojnë gamën e tyre të shërbimeve. Ato rrisin konkurrencën dhe qarkullimin e tyre dhe rrjedhimisht të ardhurat dhe punësimin në rajon.
- Përmes bashkëpunimit rregullohet dhe krijohet një proces i rregullt midis nevojave të sipërmarrjëve dhe ofertës arsimore të shkollës.
- Kërkesa për formim profesional në qendrën e shkollës profesionale "Shën Jozefi Punëtor" është rritur për shakak të cilësisë më të lartë të ofertave të saj të trajnimit dhe në tërësi vlerësohet nga shoqëria si shembullor për trajnimin dhe arsimin profesional në Shqipëri.

Në cilat pika do të përqëndrohet projekt?

Në nivelin e shkollës profesionale duhet të jëte një përqendrim në mobilizim rrethë fushës së formimit profesional (dual) praktik. Këto masa kërkojnë një ndërtim vendimtar të aftësive organizative dhe të personelit midis partnerëve shqiptarë të përfshirë në projekt. Kështu që priorititet e tjera të mundshme për zbatimin e projektit, që vihen në diskutim, janë:

- Trajnimi i mësuesve në lëndët praktike profesionale (Train-the-Trainer).
- Këshillim/zhvillim i kurrikulave, materialeve mësimore, profileve profesionale dhe provimeve.
- Këshillë për krijimin e bordeve të provimeve dhe zhvillimin e provimëve.
- Vendosja e lidhjeve sistematike me ekonominë lokale dhe përfaqësimin në nivelin kombëtar.
- Këshillë organizative dhe menaxheriale për institucionet partnere për krijimin e kurseve praktike të trajnimit me sipërmarrje.
- Organizimi dhe implementimi i kurseve pilot.
- Zhvillimi i një kulture trajnuese në kompani.
- Futja e një funksioni-monitorimi në aftësimin profesional nga dhoma përgjegjëse.
- Mbështetje me punën pedagogjike, orientimin dhe përgatitjen e karrierës.
- Këshilla për teknologji dhe pajisje.
- Sektorët e mundshëm të trajnimit janë: Automekanik, Mekatronik, Elektronist për teknikë të energjisë dhe ndërtimit, Mekanik për pajisje në sanitari, ngrohje dhe ajër të kondicionuar, turizëm.

Partneri kontaktues

Franc Musolli
Menaxher i Projektit
Handwerkskammer Dortmund
Ardeystraße 93
44139 Dortmund
Tel.: +49(231)5493-401
Fax: +49(231)5493-95401
E-Mail: franc.musolli@hwk-do.de
Internet: www.hwk-do.de